

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
8	6.1.2021	Kerkese per informacion mbi historine e mureve te Duresit, pjesa e ndertimit , me qellim mbrojtjen e temes se diplomes.	12.1.2021	Ne vijim te kerkeses suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin grafik arkivor per muret dhe kullat e kalase se Duresit (vitet '80-te shek.XX). Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
9	6.1.2021	Kerkese per informacion monumentin Ura e Kamares, per qellime studimore	12.1.2021	Ne vijim te kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor nga dosje teknike Nr.-- per objektin “Ura e Kamares”, ne fshatin Mirake, Librazhd, si me poshte: 1. Dokumentacion fotografik; 2. Dokumentacioni pershkrimor (viti 1984,1986) 3. Pamje dhe planimetri te ures (viti 1978, 1986). Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
10	6.1.2021	Kerkese per onformacion mbi metodat e konservimit ne shqiperi	21.1.2021	In response to your email: Actually the topic that you are covering in your research is very wide and cannot thoroughly be answered via email. However I shall try to direct you to the sources you can use for your research. Unfortunately a large part of the references are in albanian. The legal protection of the Cultural heritage in Albania started in 1912 recommending by a normative act (Circular Regulation) the protection of historic heritage (named at that time as "old things"). Later in 1948 the first National List of Cultural Monuments was adopted by Law. The practice of conservation in Albania has started at the same time with the awareness for the protection of the cultural heritage but in institutional manner it started in the 1950s through the Group of Material Culture having several Regional Ateliers in the main regions of Albania. The founding of the Institute of Cultural Monuments (now named National Institute for Cultural Heritage) dates back to 1965. References to the Theory and practice of Restoration in Albania can be found with author Aleksander Meksi and Emin Riza (in albanian unfortunately) as below: - <i>Emin Riza (2002) Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës. Instituti I Monumenteve të Kulturës, Tiranë,</i> - <i>Aleksandër Meksi (2004) Restaurimi i monumenteve të arkitekturës, Uegen, Tiranë</i> For your information, please find attached the english version of Law 27/2018 as well as word version of Decision of Council of Ministers No. 1099, issued on 24.12.2020 "On the approval of treatment methods, technical norms, criteria and models of interventions in the field of conservation of cultural assets". The Decision provides recommendations and norms for use from the professionals in cultural heritage during conservation and	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

				restoration. It is in albanian - since it is in .doc version you can google.translate.		
11	6.1.2021	Kerkese e deleguar: Kerkohet informacion mbi listen e monumenteve te kultures se Qytetit Tirane, Aktet e shpalljes si dhe aktet te cilat kane bere ndryshimet ne statusin e obejkteve pas dates 16.7.2015.	21.1.2021	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, përcjellë nga Ministria e Kulturës ju informojmë se: Lista e pasurive kulturore (monument kulture) për Republikën e Shqipërisë, gjendet i publikuar në faqen zyrtare të IKTK : www.iktk.gov.al . Ky informacion, bazuar ne Ligjin 119/2014 “Per te drejten e informimit” është i publikuar pa kërkesë në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe është në përditësim të vazhdueshëm. Informacionin mund ta aksesoni në linkun si vijon: http://iktk.gov.al/site/pasuri-kulturore/ Në lidhje me pikën 2 dhe 3 të kërkesës suaj, dokumentacionin e gjeni në link-et bashkëlidhur : https://we.tl/t-ABeYBrvM3b , https://we.tl/t-2972TwG1dt .	E plote	JO
14	6.1.2021	Kerkese per informacion mbi projektet kulturore te financuara nga BE nga 2009, me qellim analizimin se si perceptohet nga popullata dhe cili eshte ndikimi i tyre ne ndjenjen me afer BE ne funksion te nje pranimi te mundshem. Informacioni kerkohet per qellime studimore nga student.	21.1.2021	first of all, thank you for your email and research in such an interesting topic. in response to your request sent via email to info@iktk.gov.al : communitarian programs such as culture programme 2007 - 2013 named later as creative europe 2014 - 2021 as well as europe for citizens are programs followed by the ministry of culture through its directorate of integration. We highly recommend you to contact the ministry of culture - directorate of integration via the official email address: info@kultura.gov.al where we believe that you can get more accurate information regarding your question.	E plote	JO
36	8.1.2021	Kerkese per nderhyrje ne banesen monument kulture “Kulla e Abat Docit”	15.1.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Sektori i Qendrave Historike, Arkitektura e Traditës dhe Peizazhit në IKTK ka përfshirë në planin e saj vjetor për vitin 2021 hartimin e projektit të restaurimit për objektin “Banesa e Abat Prend Docit” në Rubik, Mirëditë. Në kuadër të këtij procesi, kërkojmë nga ana Juaj nëse mund të na vini në dispozicion dokumentacionin e pronësisë, i cili do i bashkëlidhet projektit me qëllim aplikimin online për marrjen e lejes në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë e Kulturës.	E plote	JO
68	14.1.2021	Kerkese e deleguar: Kerkohet informacion mbi pikturën murale ne kishen shpelle te Manastirit te ShenMerise se Kostarit, per qellime te pergatitjes se temes se diplomes. Perfshirja dhe analiza e mostrave mikroskopike nag periferia e pikturës, etj.	20.1.2021	Në përgjigje të kërkesës: Shpella e Manastirit të Shën Mërisë në Kostar përfaqëson një monument të një rëndësie të veçantë historike, artistike dhe kulturore, e cila përmban disa faza pikturë, të periudhës bizantine dhe pasbizantine, arsye për të cilat gëzon statusin e monumentit të Kategorisë I. Si rrjedhojë, si institucion i specializuar në fushën e Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), synon jo vetëm mbrojtjen e pikturës murale të monumentit, trajtimin profesional dhe monitorimin e saj, por njëkohësisht garanton edhe rëndësinë e vlerave të prekshme dhe të paprekshme të monumentit për shoqërinë dhe komunitetin, dhe inkurajon kërkimet shkencore që mbrojnë dhe artikulojnë këto vlera. Bazuar në rëndësinë e mësipërme të monumentit "kisha shpellë e Manastirit të Shën Mërisë në Kostar", rekomandojmë fillimisht të merret parasysh realizimi i një marrëveshjeje ndër-institucionale paraprake bashkëpunimi midis Ministrisë së Kulturës, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Universitetit Teknik të Athinës Perëndimore. Njëkohësisht, duke marrë parasysh që marrja e kampioneve të pikturës është	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

				një proces shumë delikat, dhe klasifikohet si një ndërhyrje në një vepër arti të një rëndësie të veçantë, duhet të jetë shumë i kontrolluar. Si rrjedhojë: E gjithë procedura të shoqërohet nga një program preciz dhe të detajuar dokumentimi në formën e një raporti/projekti, i ilustruar me vizatime, fotografi, etj. të pikturës dhe të zonave ku do të merren kampionet, si dhe të vlerësohet në mënyrë kritike e të argumentohet mundësia e marrjes ose jo të mostrave (në rast se studimi dhe vlerësimi do të përfshijë marrjen e mostrave për analizë) në shtresëzimet e ndryshme të pikturës, siç ndodh në rastin e Shën Mërisë në Kostar. Nëse marrëveshja ndërinstitutionale për bashkëpunim do të nënshkruhet, theksojmë se bazuar në ligjin Nr. 27/2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 77, projekti duhet të marrë miratimin e Këshillit Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore Materiale. Pasi kërkesa të vlerësohet nga institucionet kompetente rekomandojmë që: 1. Bazuar në praktikën e deritanishme të zbatimit, por edhe në vijim, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 1099, datë 24.12.2020 <i>“Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”</i> dhe Kartat Ndërkombëtare të Restaurimit, siç është Karta e Venecias, sugjerohet që në rastin e marrjes së kampioneve (mostrave) të pigmenteve, kjo procedurë të kryhet në ato zona periferike ku piktura murale paraqet degradim të dukshëm me sy, pra shpëputje të shtratit pikturor nga suporti i murit, në mënyrë që i gjithë procesi të jetë sa më pak invaziv dhe të mos cenohet në asnjë rast lexueshmërinë e pikturës apo të rrezikojë hapjen e vatrave të reja të degradimit. 2. E gjithë procedura e marrjes së kampioneve në zonat skajore/periferike që paraqesin degradim të dukshëm të pikturës, duhet të mbahet në një nivel të nevojshëm minimal për të shmangur çdo lloj rreziku të përcaktuar më lart. 3. Njëkohësisht është e nevojshme mbikëqyrja e gjithë procesit nga një specialist i artit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë.		
69	15.01.2021	Kerkese per informacion mbi pallatin qe po ndertohet perbri Bulevardit “Dyrrah “ Durres	29.01.2021	Ne pergjigje te kerkeses Suaj në lidhje me <i>“Pallatin nr. 14, zona kadastrale nr. 8514, pasuria nr. 1/362, Bulevardi Dyrrah Durrës”</i>, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 69 Prot., bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” ju bejme me dije se : Bashkëlidhur këtij e-mail gjeni përgjigjet e kërkesave dhe materialin përkatës.	E Plote	JO
82	18.1.2021	Kerkese per materiale per monuemntin Kalaja e Bashtoves, per qellime te mbrojtjes se diplomes	22.1.2021	Ne vijim te kërkesës Suaj: Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin e vjetër arkivor, grafik dhe fotografik (para viteve 90-te), per objektin monument kulture “Kalaja e Bashtoves”, me kod arkivi Nr. -. https://we.tl/t-HvAjeOnKF1. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik IKTK).	E plote	JO
83	18.01.2021	Kerkese per informacion mbi procesin e rindertimit te shkollave brenda zones arkeologjike ne Durres	04.02.2021	Ne vijim te kerkeses suaj: Ju dergojme bashkëlidhur në link dokumentacionin shoqerues. https://www.dropbox.com/t/6KeoX2WwaSxVyb5s Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik IKTK).	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

84	18.01.2021	Kerkese per informacion mbi procesin e rindertimit brenda zonave arkeologjike	04.02.2021	Ne vijim te kerkeses suaj: Ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin shoqerues. https://www.dropbox.com/t/Ae2tNStiBYqiczB5 Sa me sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik IKTK).	E plote	JO
109/1	03.02.2021	Kerkese per materiale arkivore mbi Kishen e Shen Kollit Vanaj, Fier.	04.02.2021	Në vijim të kërkesës Suaj : Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor grafik dhe përshkrimor (para viteve 90te shek XX), për objektin “Kisha e Shen Kollit Vanaj”, Fier (monument kulture kategoria I), me kod arkivi Nr. -. https://we.tl/t-Uy1H8nVnpJ Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
132	22.01.2021	Kerkese per informacion mbi projektin e Amfiteatrit te Duresit	10.02.2021	Ne vijim te kerkeses suaj: Ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin shoqerues. https://we.tl/t-sOaaPpuWkV Sa me sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik IKTK).	E plote	JO
133	22.01.2021	Kerkese per informacion mbi statusin e objektit “Shtepia e Heroit Lefter Talo” Livadhia, Sarande.	26.01.2021	Ne pergjigje te kerkeses suaj, ju bejme me dije se : 1. Banesa e Lefter Talos, ne Sarande, nuk gezon statusin pasuri kulturore sipas dispozitave te ligjit Nr.27/2018 “Per trashegimime kulturore dhe muzete” 2. Prane arkivit te Institutit Kombetar te Trashegimise Kulturore, ka materiale arkivore rreth ketij objekti, me konkretisht : planimetri e katit perdhe, planimetri e katit te pare, fasade kryesore dhe fasade anesore. Bashkelidhur gjeni kopje te materialeve te siperpermendura .	E deleguar	JO
136	25.01.2021	Kerkese per informacion per listen e monumenteve qe rrezikojne nga permbytjet	10.02.2021	Ne vijim te kerkeses suaj: Ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin shoqerues. https://we.tl/t-beceCKauj9 Sa me sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik IKTK).	E plote	JO
138	25.01.2021	Kerkese per materiale , te dhena per Kishen e Shen Merise ne Elbasan	27.01.2021	Ne pergjigje te kerkeses Suaj: Ju dergojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor grafik, fotografik dhe pershkrimor te viteve ‘80 te shek. XX-te dhe vitit 2006, per objektin “Kisha e Shen Merise (katedralja)", Lagjia "Kala", ne qytetin e Elbasanit me kod arkivi Nr.-. https://we.tl/t-akwF0bKOP3 . Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
158	28.01.2021	Kerkese per kopje te dokumentacionit te baneses se tij si dhe kerkese per rishikim,korigjim projekti	11.02.2021	Ne vijim te kerkeses Suaj: Ju dergojmë bashkëlidhur dokumentacionin e kerkuar . Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik IKTK).	E plote	JO
192	02.02.2021	Kerkese per te ndihmuar studentet qe ndjekin Programin e Ciklit te Dyte te Studimeve, Master profesional ne Restaurimin e Monumenteve te Kultures, ne Fakultetin e Arkitektures dhe Urbanistikes, te Universitetit Politeknik te Tiranes	03.02.2021	Ne vijim te kerkeses Suaj: Ju dergojmë bashkëlidhur dokumentacionin e kerkuar grafik , fotografik dhe pershkrimor per objektet e kerkuara. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

193	02.02.2021	Kerkese per informacion ne lidhje me Muzeun Historik te Vlores , relacion historiuku , rilevim te tij dhe projekti i restaurimit te muzeut	03.02.2021	Ne vijim te kërkesës Suaj: Ju dërgojmë bashkëlidhur ne link dokumentacionin e kerkuar grafik , fotografik dhe pershkrimor per objektin “Muzeu Historik”, ne qytetin e Vlores, shpallur “monument kulture” ne vitin 2016, me kod arkivi Nr. -. https://we.tl/t-NrnEdiq3RR Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
250	10.02.2021	Kerkese per harta dhe pdv per qytetin e Krujes, deleguar nga MK.	11.02.2021	Ne vijim te kërkesës Suaj Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor perkatesisht: - Planimetrinë e “Kalasë Krujë” dhe të “Pazarit të vjeter Krujë”, në format pdf. https://we.tl/t-gp1x4Og4vJ Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
260	11.02.2021	Kerkese per pajisjen me kopje te procesverbalit te mbledhjes se KKA-se per projektin Depozite Bregdetare ne zonen energjitike dhe industriale te Porto Romano Durres	11.03.2021	Ne vijim te kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Materialin e kërkuar e gjeni në formë elektronike (CD) bashkëlidhur kësaj shkrese.	E plote	JO
262	11.02.2021	Kerkese per formatin elektronik te revistes Historia e Arkitektures	17.03.2021	Ne pergjigje te kerkeses suaj, ju bejme me dije se : Në lidhje me Revistat "Monumentet", versionin online e gjeni në faqen tonë web. Të gjitha revistat janë hedhur aty dhe informacionin për çdo revistë mund ta aksesoni po aty. Shitje të formatit online të revistës nuk praktikojmë, por për çdo numër të ri që ne botojmë, ju keni kopjen tuaj fizike, të cilën duhet të vini ta tërhiqni pranë magazinës sonë. Numri ynë i fundit është 59. Universiteti juaj është i përfshirë në listën tonë të shpërndarjes së revistës dhe si i tillë bëhet përfitues i çdo botimi të ri pa kurrfarë pagese.	E plote	JO
318	23.02.2021	Kerkese per informacion nese ka Plane Menaxhimi te Pasurive te TK .	26.02.2021	Në vijim të kërkesës suaj , administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 318 Prot., date 23.02.2021, , Ju bëjmë me dije se: Në mbështetje të V.K.M.-së Nr. 169, date 20.02.2020 ".Deri më tani nuk kemi plane te tjera të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, në gdo rast ato publikohen në fletoren zyrtare www.qbz.gov.al).	E plote	JO
325	24.02.2021	Kerkese per kartelen e objektit Monument Kulture kategoria e II-te , “banese tip vile 1 kat “.	26.02.2021	Në vijim të kërkesës suaj me date 24.02.2021 administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.325 Prot : Bashkelidhur ju dergojme kartelen per monumentin e kategorise se II-te “ Banese tip vile 1 kat “ , Rruga “Dervish Hekali” , ne qytetin e Tiranës, me kod II-209 . Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

313	22.02.2021	Kerkese per kryerjen e praktikës mesimore	16.03.2021	<i>Në përgjigje të kërkesës suaj për të ndjekur praktikën mesimore pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore - IKTk, si dhe duke iu referuar degës së studimeve bachelor (Histori), mund të angazhoheni pranë Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik (DSHA), IKTk. Lutemi të plotësoni dokumentacionin e dërguar (CV dhe Kërkesë) duke sjellë dhe Vërtetim studentit. Mund të paraqiteni pranë ambjentëve të IKTk-së, Sektori i financës për të sjellë dokumentin (Vërtetim studentit). Në IKTk mund të bëni takim me sektorët përkatës pranë DSHA-së për të përcaktuar kohën më të përshtatshme si dhe modalitetet për realizimin e praktikës mesimore (referuar edhe situatës COVID).</i>	E plote	JO
317/1	02.03.2021	Kerkese per informacion per vilat ne Tirane	10.03.2021	Për periudhën 2016-2021, IKTk-së nuk i janë akorduar fonde publike për mirëmbajtjen e vilave/banesave me status monument kulture në qytetin e Tiranës, të shpallura në Vitin 2015. Në lidhje me planin për restaurimin e vilave/banesave për 5 vitet e ardhshme, Ju informojmë se IKTk nuk ka ende një plan të miratuar 5-vjeçar. Bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 22, pronari dhe/ose poseduesi i pasurisë kulturore ka detyrimin për ruajtjen dhe mbajtjen në gjendje të mirë pasurinë kulturore duke respektuar dispozitat e këtij ligji.	E plote	JO
317/3 317/4	12.03.2021 23.03.2021	Kerkese per informacion per banesat ne Tirane	26.03.2021	Në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: - Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës (DRKK), sot Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë (DRTK), gjatë periudhës 2015-2018, ka përditësuar kartelat e të gjithë pasurive kulturore të Qarkut Tiranë, monumente kulture të kategorisë së I-rë dhe të II-të, dhe ka kryer vlerësimin e gjendjes së konservimit të këtyre pasurive; - Lidhur me kërkesat për ndërhyrje në objekte pasuri kulturore tip vila në qytetin e Tiranës janë miratuar 11 projekte me vendime KKR dhe KKTKM në periudhën 2015-2020; Mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë IKTk, janë administruar 15 kërkesa për deklarimin e mungesit të interesit kulturor nga ana e pronarëve të objekteve, për arsye të ndryshme. Lidhur me deklarimin e mungesës së interesit kulturor, nuk disponohen ende akte ligjore, nënligjore, rregullore apo dokumenta që përcaktojnë kushtet kur objekti nuk përmbush kriteret e ekzistencës së interesit kulturor. Kërkesat për deklarimin e mungesës së interesit kulturor shqyrtohen rast pas rasti në Këshill Teknik dhe në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) bazuar në relacionet argumentuese të depozituara të hartuara nga subjekte të licensuar në fushën e restaurimit në përputhje me ligjin 27/2018;	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

				- Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në IKTK nuk rezultojnë shkresa të depozituara në lidhje me kërkesat për mirëmbajtje të pasurive kulturore tip vila të shpallura me Urdhrin Nr.276, datë 16.7.2015; - Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në periudhën 2018-2020, nuk rezultojnë akte kontrolli të kryera, apo masa të marra ndaj pronarëve të objekteve për mos përmbushjen e detyrimit për mirëmbajtjen e pasurisë kulturore tip vila, të shpallura me Urdhrin Nr.276, datë 17.6.2015; - Në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, IKTK nuk disponon fonde të posaçme nga buxheti i shtetit për të siguruar pasuritë kulturore duke sjellë vështirësi në marrjen e masave konkrete në rrethana të rrezikut ose dëmtimit të këtyre të fundit.		
365	01.03.2021	Kerkese per statusin e vilave ne TËrane	19.03.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Procedura për verifikimin dhe deklarimin e interesit kulturor kryhet në zbatim të Nenit 57-70, të <i>Kreut II – Verifikimi dhe deklarimi i interesit kulturor dhe regjistrimi i pasurisë kulturore</i>, të pjesës së dytë “<i>Identifikimi, Mbrojtja dhe Vlerësimi i Pasurive Kulturore</i>”, të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Ministria e Kulturës së bashku me institucionet e saj të varësisë së trashëgimisë kulturore, ushtrojnë funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore të deklaruara sipas dispozitave ligjore të trashëgimisë kulturore. Nëse objekti humbet statusin e mbrojtjes sipas Ligjit 27/2018, ndryshimet e mundshme të destinacionit të objektit nuk janë objekt i studimit nga ana e Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të saj të varësisë. Bashkëlidhur gjeni listën e objekteve pasuri kulturore të qarkut të Tiranës nga viti 2013-2020, ku janë të evidentuara të gjithë Urdhrat e deklarimit të pasurive kulturore. Nga viti 2013-2020, kanë humbur statusin pasuri kulturore 37 objekte në qarkun Tiranë. Procesi i mungesës së deklarimit të interesit kulturor shqyrtohet në KKTKM, bazuar në relacionet argumentuese të depozituara në Sekretarinë Teknike.	E plote	JO
406	08.03.2021	Kerkese per dokumentacionin teknik te xhamise se Nazireshes ne Elbasan.	12.03.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin arkivor grafik, fotografik dhe përshkrimor (para viteve 90-te shek XX), për objektin “Xhamia e Nazireshtes”, Elbasan (monument kulture kategoria I). me kod arkivi Nr,- https://we.tl/t-pLTFq1rw7	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

				Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).		
437	08.03.2021	Kerkese mbi problematiken e banese se Cuberateve ne Gjirokaster.	31.03.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bejme me dije se : Ne lidhje me informacionin e kerkuar mbi banesen "ÇUBERI", DRTK Gjirokaster po ju vendos ne dispozicion informacionin e kerkuar nga ana e juaj si me poshte: 1-Statusi i objektit: Banesa Çuberi e ndodhur në lagjen "Partizani" në Zonën Historike të Gjirokastrës është monument culture kat I-rë me kod identifikimi Nr 109003 . 2-Objekti sot ndodhet në gjendje kritike, është pa dyer e dritare, pa suvatur , pa ndërkatë (janë rrënuar) dhe është e mbushur me mbeturina ndërtimi. Në restaurimin e fundit që është bërë në këtë objekt të gjitha mbetjet që kanë dalë nga restaurimi kanë ngelur brenda banesës dhe të jep përshtypjen e një mbledhëse mbeturinash. 3-Banesa është unike por në pronësi ajo është e ndarë në mënyrë simetrike. Banesa me kod kadestarl 10/102 është pronë e z. Eduart dhe Nedine Çuberi kurse pjesa tjetër me kod 10/71 është pronë shtetërore por nuk administrohet nga askush. 4-Objekti si i tërë nuk është i ndarë por është ndërtuar në mënyrë të tillë që ka komunikim me të gjitha pjesët. Sot është i pabanuar për arsyet e sipërcituara; i mbushur me mbeturina dhe pa dyer e dritare.	E plote	JO
479	22.03.2021	Kerkese per informacion per maternitetin Mbreteresha Geraldine			Ne proces	
483	23.03.2021	Delegim Kerkese nga MK			Ne proces	
484	23.03.2021	Percjellje Kerkese per kompetence e bashkimit te operatoreve per projektin e ndertimit te godines se parkimit dhe hapesirave mbeshtetese ne Gjirokaster			Ne proces	
488	23.03.2021	Delegim Kerkese per projektin Plani i konservimit dhe nderhyrje perforcuese dhe restauruese te Kisha e Manastirit te Rubikut nga MK			Ne proces	
503	24.03.2021	Kerkese per material grafik te Kalase Gjirokaster dhe Berat	30.03.2021	Në vijim të kërkesës Suaj , Ju dërgojmë bashkëlidhur në link materialin e vjetër arkivor për objektet “Kalaja e Beratit” dhe “Kalaja e Gjirokastrës” si: - dokumentacion teknik grafik (planimetri, fasada, prerje); - dokumentacion fotografik. me kod arkivi Nr,- https://we.tl/t-LBIMMqPO9C Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).	E plote	JO
505	24.03.2021	Kerkese per informacion per Mesonjetoren e Korces	24.03.2021	Deleguar per kompetence Ministrise se Kultures .	E plote	JO
505/1	25.03.2021	Kerkese per informacion per Mesonjetoren e Korces			Ne Proces	
517	26.03.2021	Kerkese per dokumentacion nga arkivi per Xhamine e Plumbit Shkoder	30.03.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link dokumentacionin e vjetër arkivor grafik dhe përshkrimor për objektin “Xhamia e Plumbit”, Shkodër, (monument culture kategoria I) me kod arkivi Nr,- https://we.tl/t-CXpe1bruSS	E plote	JO

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR – MARS 2021

				Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).		
534	31.03.2021	Kerkohet dosja e plote e objektit nr, 210, kodit II-74 “Ish ATSH ne BLv. Zogu i I-re”, ne listene monumenteve te kultures ne Tirane, me Vendimin nr. 122 date 5.3.2007. A ka nje vendim dhe akt ekspertimi qe i heq statusin monument kulture ketij objekti? Nese po, kerkohet kopje e ketij akti dhe vendimmarrjes shoqeruese.			Ne proces	